

## **Pyetje rreth kartave dhe rrjetit të Intesa Sanpaolo Bank Albania**

### **Çfarë është karta?**

Karta i referohet çdo karte VISA ose MasterCard të lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank Albania. Nëse karta ka shenjën dalluese VISA, mund të përdoret në çdo Makinë ATM, ose instalim tjetër që shfaq logon VISA. Nëse karta ka shenjën dalluese MasterCard, mund të përdoret në çdo Makinë ATM ose instalim tjetër që shfaq logon MasterCard.

### **Çfarë është një ATM?**

Një ATM (*makinë sportel e automatizuar*) është një aparat elektromekanik, të cilin mund ta përdorni me kartën dhe me një PIN (*Personal Identification Number – numër personal identifikimi*) të vlefshëm për të tërhequr cash dhe për të kryer shërbime të tjera bankare.

### **Kujt i jepet e drejta për të patur një kartë?**

Kartat janë të vlefshme për të gjithë personat që kanë llogari rrjedhëse pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania.

**Shënim:** Personat të cilët aplikojnë për një kartë MasterCard Gold duhet fillimisht të marrin miratimin nga Banka.

Shihni më poshtë se si mund të aplikoni për t'u pajisur me një kartë.

### **Cila kartë më përshtatet mua?**

Nëse karta ju nevojitet kryesisht për të kryer pagesa për mallra apo shërbime në **Lek**, apo për të tërhequr pagën tuaj mujore në Lek nga Makinat ATM, atëherë karta **Visa Electron** është karta ideale për ju, duke qënë se të gjitha veprimet e kryera duke përdorur këtë kartë shprehen në Lek.

Nëse karta ju nevojitet për të kryer pagesa për mallra apo shërbime kryesisht në **USD**, atëherë karta **Visa Classic** është karta e duhur për ju, duke qënë se të gjitha veprimet e kryera duke përdorur këtë kartë shprehen në USD.

Nëse shpenzimet tuaja konsistojnë kryesisht në EUR, atëherë secila nga kartat tona MasterCard do të ishte një kartë e përshtatshme për ju duke qënë se të gjitha veprimet e kryera duke përdorur këto karta shprehen në EUR.

**Shënim:** Ju mund të aplikoni për të marrë më shumë se një kartë. Monedha e kartës ju ndihmon të shmangni kurset e këmbimit gjatë kryerjes së veprimeve në një monedhë të ndryshme nga monedha e kartës suaj.

### **Si duhet të aplikoj për t'u pajisur me kartë?**

Vizitoni degën apo agjensinë më të afërt të Intesa Sanpaolo Bank Albania për të aplikuar për kartë. Shërbimi i Klientelës i përcaktuar për këtë qëllim do t'ju ndihmojë të plotësoni formularin e aplikimit.

### **Si e marr unë kartën dhe PIN-in?**

Për arsye sigurie, ju duhet të paraqiteni në degën apo agjensinë më të afërt të Intesa Sanpaolo Bank Albania, ku keni plotësuar formularin e aplikimit, për të marrë kartën dhe PIN-in tuaj.

### **Çfarë duhet të bëj pasi të kem marrë kartën dhe PIN-in?**

Ju duhet të nënshkruani në panelin e firmës në anën e pasme të kartës menjëherë sapo ta merrni atë. Asnjëherë mos e shkruani PIN-in tuaj, veçanërisht mbi kartë – mbajeni mend atë. Në rast se vendosni të ndryshoni PIN-in tuaj, mos zgjidhni numra të cilët mund të jenë lehtësisht të identifikueshëm ose që kanë lidhje me ju. Psh. mos përdorni datën e lindjes apo numrin tuaj të telefonit.

### **A mund të kem kartë shtesë?**

Po, ju mund të kërkonti që ne të lëshojmë një kartë shtesë për një apo më shumë persona, të përzgjedhur nga ju dhe të aprovuar nga ne për t'u pajisur me kartë shtesë që lidhet me llogarinë tuaj.

### **Si mund të aplikoj për një kartë shtesë?**

Ju mund të aplikoni për kartë shtesë që në momentin kur aplikoni për kartë për veten tuaj, ose dhe në çdo moment tjetër kur ju dëshironi, duke plotësuar nje formë aplikimi të veçantë. Si ju ashtu edhe personi që do të pajiset me kartë shtesë, duhet të jeni të pranishëm në degë apo agjensi për të plotësuar dhe firmosur formularin përkatës.

### **Si ta përdor kartën në një ATM?**

- Futeni kartën në ATM. Vendi ku karta duhet të futet tregohet nga një dritë jeshile që pulson.
- Zgjidhni opsionin e gjuhës që preferoni duke shtypur butonin përkatës në anën e djathtë të ekranit.
- Futni PIN-in tuaj aty ku tregohet.
- Zgjidhni shërbimin e kërkuar duke shtypur butonat përkatës në anën e majtë ose të djathtë të ekranit.
- Ju lutemi vereni se ju mund të zgjidhni të printoni apo jo një faturë.

## **Çfarë veprimesh mund të kryej, duke përdorur kartën në ATM-të e Intesa Sanpaolo Bank Albania?**

### **1- Tërheqje cash-i:**

Ndiqni udhëzimet që shfaqen në ekranin e ATM-së.

- Zgjidhni “Tërheqje” duke shtypur butonin e dytë në anën e djathtë të ekranit të menisë kryesore.
- Zgjidhni monedhen LEK/EUR (në ato ATM ku aplikohet, ju lutemi referojuni listës së ATM-ve).
- Përzgjidhni shumën që ju dëshironi të tërhiqni nga mundësitë që ofrohen.
- Zgjidhni llogarinë që do të debitohet duke e klikuar zgjedhjen që bëtë dhe më pas shtypni butonin “Vazhdoni”.
- Prisni të merrni lekët dhe faturën, nëse keni zgjedhur që ajo të printohet.

MOS HARRONI TË MERRNI KARTËN.

### **2- Transfertë:**

Ju mund të transferoni para nga një llogari e lidhur me kartën tek një llogari tjetër e lidhur me kartën.

- Zgjidhni “Transfertë” duke shtypur butonin e tretë sipër majtas në menunë kryesore të ekranit.
- Zgjidhni një nga mundësitë.
- Futni shumën në Lek që do të transferoni dhe më pas shtypni butonin “Vazhdoni”, ose shtypni butonin “Ndryshoni shumën” në qoftë se bëni ndonjë gabim.
- Zgjidhni llogarinë që do të debitohet duke futur zgjedhjen që bëtë, dhe më pas shtypni butonin “Vazhdoni”.
- Zgjidhni llogarinë që do të kreditohet duke futur zgjedhjen që bëtë dhe më pas shtypni butonin “Vazhdoni”, ose korrigjoni zgjedhjen tuaj në qoftë se bëni ndonjë gabim.
- Prisni për faturën, nëse keni zgjedhur që ajo të printohet.

MOS HARRONI TË MERRNI KARTËN.

## **Çfarë informacioni mund të marr unë, duke përdorur kartën në ATM-të e Intesa Sanpaolo Bank Albania?**

### **1-Verifikim bilanci:**

- Për të marrë një bilanc të printuar të llogarisë tuaj, zgjidhni “Verifikim bilanci” duke shtypur butonin e parë, sipër djathtas në menunë kryesore të ekranit.
- Përzgjidhni llogarinë duke futur zgjedhjen që bëtë dhe më pas shtypni butonin “Vazhdoni”.
- Prisni për faturën.

MOS HARRONI TË MERRNI KARTËN.

### **2-Nxjerrje llogarie:**

ATM-të e Intesa Sanpaolo Bank Albania ju ofrojnë ju mundësinë për të parë veprimet e fundit në llogarinë tuaj, duke printuar një mini nxjerrje llogarie.

- Zgjidhni “Nxjerrje llogarie” duke shtypur butonin e tretë sipër djathtas në menunë kryesore të ekranit.
- Përzgjidhni llogarinë duke futur zgjedhjen që bëtë dhe më pas shtypni butonin “Vazhdoni”.
- Prisni për faturën.

MOS HARRONI TË MERRNI KARTËN.

### **Çfarë mund të bëj tjetër?**

Ju mund të ndryshoni PIN-in tuaj në çdo kohë, duke përdorur ATM-të e Intesa Sanpaolo Bank Albania.

- Zgjidhni “Ndryshoni PIN” duke shtypur butonin e katërt sipër majtas në menunë kryesore të ekranit.
- Futni PIN-in tuaj të ri.
- Futeni përsëri PIN-in tuaj të ri për ta konfirmuar atë.

MOS HARRONI TË MERRNI KARTËN.

### **Po nëse po përdor një kartë VISA ose MasterCard të lëshuar nga një bankë tjetër brenda ose jashtë vendit?**

Në këtë rast mund të kryeni tërheqje në LEK (ose EUR në ATM të caktuara ju lutemi referojuni listës së ATM-ve) nga llogaria që ju keni zgjedhur si llogarinë tuaj kryesore pa asnjë komision nga ana e Bankës sonë.

Gjithashtu ju mund të kryeni edhe verifikim të gjendjes së llogarisë.

### **Ku mund t’i gjej ATM-të e Intesa Sanpaolo Bank Albania?**

ATM-të e Intesa Sanpaolo Bank Albania janë vendosur dhe mund të gjenden në të gjitha degët dhe agjensitë e bankës si dhe në vendodhje të tjera. Adresat përkatëse mund t’i gjeni në faqen tonë të internetit [www.intesasanpaolobank.al](http://www.intesasanpaolobank.al) Për më tepër informacion, ju lutemi vizitoni degët apo agjensitë tona.

### **Ku mund ta përdor kartën?**

Ju mund ta përdorni kartën në miliona Makina ATM që shfaqin shenjat dalluese VISA dhe/ose MasterCard, në Shqipëri dhe jashtë saj, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Gjithashtu, ju mund të përdorni kartën për të kryer pagesa për mallra apo shërbime në çdo pikë shitje në botë ku shfaqen shenjat dalluese VISA dhe/ose MasterCard.

Kartat e Intesa Sanpaolo Bank Albania (*duke përjashtuar kartën VISA Electron dhe Inspire*) mund të përdoren dhe për të kryer rezervime në hotele, prenotime biletash udhëtimi, blerje nëpërmjet Internetit, etj.

### **Çfarë veprimesh mund të kryej duke përdorur kartën time të Intesa Sanpaolo Bank Albania në ATM-të që nuk janë të Intesa Sanpaolo Bank Albania?**

**Tërheqje cash-i:** Ju mund të tërhiqni cash nga llogaria, që ju e keni zgjedhur si llogarinë tuaj kryesore.

### **A ka ndonjë limit ditor të caktuar për tërheqjen e cash-it apo për shpenzime që mund të kryej me kartën?**

Po. Për çdo kartë, Intesa Sanpaolo Bank Albania ka përcaktuar limite standarte ditore të cilat janë të përcaktuara në Kushtet e Punës Megjithatë, nëse ju nevojitet, ju mund të kërkonte nga Banka limite më të larta përdorimi.

### **A paguaj ndonjë komision për t'u pajisur me kartë?**

Ju nuk paguani asnjë komision për t'u pajisur me kartë – VISA Electron/Visa Inspire. Ju duhet të paguani një Tarifë Mujore Shërbimi për kartën Visa Classic, MasterCard Standard dhe MasterCard Gold. Shuma e kësaj tarife është e publikuar në Kushtet Tona të Punës.

### **Çfarë duhet të bëj në qoftë se harroj PIN-in tim?**

Ju duhet të njoftoni Bankën në mënyrë që të merrni një PIN të ri.

### **Duhet ta kërkoj unë rinovimin për kartë?**

Jo, ju nuk keni nevojë të kërkonin rinovimin e kartës suaj. Ju do të njoftoheni nga Banka se kur duhet të paraqiteni për të marrë kartën tuaj të rinovuar.

### **Cila është Data e Skadimit për kartën?**

Data e Skadimit është e treguar qartë mbi kartë. Karta juaj është e vlefshme deri ditën e fundit të muajit të treguar mbi kartë.

### **A paguaj ndonjë komision për të rinovuar kartën time?**

Jo, ju nuk paguani asnjë komision për të rinovuar kartën tuaj.

### **Çfarë duhet të bëj në qoftë se humbas apo më vjedhin kartën?**

Raportoni humbjen apo vjedhjen e kartës menjëherë tek dega apo agjensia më e afërt e Intesa Sanpaolo Bank Albania, ose telefononi Shërbimin e Klientelës VISA / MasterCard në numrat e telefonit: **08006000 (Falas) ose +355 4 276 222 / 223**, gjatë orarit të punës. Jashtë orareve të Bankës, në fundjavë apo gjatë pushimeve, ju lutemi telefononi në këtë numër celulari: **+355 69 20 80 903**.

### **A paguaj ndonjë komision për të zëvendësuar kartën të humbur apo të vjedhur?**

Po. Komisioni për zëvendësimin e kartës është i publikuar në Kushtet tona të Punës.